



Rregullorja e kancelarit

Numri: **D-210**

Lënda: **POLITIKA DHE PROCEDURAT E ANKESAVE TË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË DISTRIKTIT PËR KOMUNITETIN DHE QYTETIN NË LIDHJE ME SJELLJEN, ANTIDISKRIMINIMIN DHE ANTINGACMIMIN**

Kategoria: **KËSHILLAT E ARSIMI TË DISTRIKTIT PËR KOMUNITETIN DHE QYTETIN**

Lëshuar më: **18 dhjetor 2025**

PËRMBLEDHJE E NDRYSHIMEVE

Kjo rregullore zëvendëson rregulloren D-210 të kancelarit, datë 22 dhjetor 2021.

Rregullorja është rishikuar për të sqaruar fushëveprimin e sjelljes që i nënshtrohet rregullores dhe procedurave të ankesave.

Përmbajtja e rregullores është modifikuar si më poshtë:

I. Hyrja

- Sqaron angazhimin e DOE-s për të afirmuar udhëheqjen e larmishme prindërore dhe fuqizimin e prindërve si agjentë të ndryshimit në shoqëri.
- Përfshin përmbledhjen e detyrave të anëtarëve të këshillit.
- Fshin referencat ndaj ligjeve, akteve nënligjore ose rregulloreve, standardeve, udhëzimeve dhe marrëveshjeve të tjera që nuk zbatohen nga rregullorja D-210 e kancelarit.

II. Përkufizimet

- Përkufizon Këshillin e Qytetit dhe Këshillin e Arsimit të Distriktit për Komunitetin (CEC) në seksionet II.A. dhe II.B. dhe rishikon përkufizimin e CEC-së për t'iu referuar këshillave të të gjithë qytetit dhe CEC-ve së bashku në seksionin II.C.
- Rishikon përkufizimin e "Sjelljes" për të sqaruar dhe kufizuar fushëveprimin e sjelljeve të parashikuara në seksionin II.B të rregullores D-210 të kancelarit.
- Përfshin përkufizimin e termit "Zbulim informacioni" në seksionin II.D.
- Përfshin përkufizimin e termit "Regjistër mësimor" në seksionin II.G.
- Përditëson përshkrimin e Zyrës për Fuqizimin e Familjes dhe Komunitetit (FACE) në seksionin II.I.

D-210 – POLITIKA DHE PROCEDURAT E ANKESAVE TË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË DISTRIKTIT PËR KOMUNITETIN DHE QYTETIN NË LIDHJE ME SJELLJEN, ANTIDISKRIMINIMIN DHE ANTINGACMIMIN

- Sqaron procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Barazisë në seksionin II.J.
- Rishikon përkufizimin e termit "Prind" në seksionin II.K.
- Rishikon përkufizimin e termit "Informacion personal i identifikueshëm" për ta harmonizuar me ligjin "Për të drejtat dhe privatësinë e familjes në arsim", 20 U.S.C. 1232g, dhe rregulloret zbatuese të tij, 34 C.F.R., pjesa 99 e në vijim (FERPA), në seksionin II.L. (PII).
- Përfshin përkufizimin e termit "Të folur" në seksionin II.O.

III. Detyrat e CCEC-ve (seksion i ri, zëvendëson seksionin I, fushëveprimi)

- Zëvendëson seksionin "Fushëveprimi" me përshkrimin e detyrave të caktuara të CCEC-ve sipas seksioneve 2590-b, 2590-c dhe 2590-e të ligjit "Për arsimin".

IV. Sjellja e ndaluar (më parë seksioni II)

- Zgjeron kategoritë e mbrojtura kundër diskriminimit ose ngacmimit në seksionin IV.A. duke përfshirë lartësinë dhe peshën, në përputhje me ligjin "Për të drejtat e njeriut të Nju-Jorkut", dhe sqaron se diskriminimi dhe ngacmimi i paligjshëm përcaktohen nga ligjet lokale, shtetërore ose federale të zbatueshme.
- Rishikon ndalimin e sjelljes ngacmuese dhe kërcënuese në seksionin IV.B.
- Zëvendëson ndalimin e disa sjelljeve të dëmshme ndaj nxënësve të DOE-s në seksionin IV.C. me ndalimin e sjelljes ose të folurit shpërqendruar.
- Rishikon ndalimin e zbulimit të "PII" në seksionin IV.D., në përputhje me përkufizimin e përditësuar sipas FERPA-s.
- Sqaron ndalimin e përdorimit të platformave të komunikimit duke shfrytëzuar statusin e anëtarit të këshillit për përfitime personale, në seksionin IV.E.
- Sqaron kërkesën që informacioni PII, duke përfshirë informacionin e kontaktit të nxënësve, i marrë nga këshilli të mund të përdoret vetëm për qëllime të ligjshme zyrtare të këshillit dhe jo për komunikime personale apo për qëllime lobimi ose fushate sipas përcaktimit në seksionin IV.F.
- Sqaron ndalimin e shfrytëzimit të pozicionit të anëtarit të këshillit për përfitime personale ose financiare për veten, anëtarët e familjes ose çdo person apo firmë me të cilën anëtari ka një marrëdhënie biznesi ose financiare, në seksionin IV.G.
- Përfshin ndalimin e hakmarrjes në seksionin IV.H. (më parë seksioni V)

V. Masat korrigjuese dhe disiplinore (më parë seksioni III)

- Sqaron se veprimet disiplinore ose korrigjuese, të diskutuara në seksionin V.A dhe B., janë të zbatueshme vetëm për shkeljet e seksionit IV të rregullores.
- Sqaron se anëtarët e këshillit që janë shkarkuar për shkelje të seksionit IV të rregullores mund të ndalohen nga shërbimi në çdo këshill në të ardhmen, sipas seksionit 2590-c dhe 2590-l të ligjit "Për arsimin" (seksioni V.C).

D-210 – POLITIKA DHE PROCEDURAT E ANKESAVE TË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË DISTRIKTIT PËR KOMUNITETIN DHE QYTETIN NË LIDHJE ME SJELLJEN, ANTIDISKRIMINIMIN DHE ANTINGACMIMIN

VI. Procesi i ankesave (më parë seksioni IV)

- Sqaron procesin e dorëzimit të ankesave në seksionet VI.A.1, 2 dhe 3.
- Sqaron në seksionin VI.A.6 se ankesat që pretendojnë shkelje që kanë të bëjnë me korrupsion, aktivitete kriminale ose konflikte interesi duhet t'i referohen zyrës/organit përkatës sipas rregulloreve D-130 dhe C-110.
- Sqaron në seksionin VI.B.1 se zyrtari për respektimin e barazisë ECO duhet të njoftojë Këshillin për Barazinë FACE për ankesat.
- Rishikon afatet kohore për hetimin e ankesave nga ECO dhe dhënien e rekomandimeve për kancelarin ose personin e autorizuar prej tij në seksionet VI.C. dhe D.
- Sqaron se kancelari ose personi i autorizuar prej tij do të japë një vendim me shkrim lidhur me faktin nëse ka pasur shkelje të kësaj rregulloreje, brenda 10 ditëve pune nga marrja e rekomandimit nga ECO, siç përcaktohet në seksionin VI.D., përveç nëse rrethanat justifikojnë zgjatjen e këtij afati.
- Rishikon procesin e pajtimit, të përcaktuar në seksionin VI.E, për ta bërë atë në përputhje me seksionin 2590-I të ligjit "Për arsimin".

VII. Apelimi (seksion i ri)

- Përfshin informacion mbi mënyrën se si anëtarët e këshillit mund të apelojnë një urdhër për pezullimin ose largimin e tyre nga detyra.

IX. Heqja dorë (seksion i ri)

- Përfshin një dispozitë që shpreh qartë se kancelari ose personi i autorizuar i tij mund të heqë dorë nga rregullorja ose çdo pjesë e saj nëse vendoset se kjo është në interesin më të mirë të distriktit shkollor të NYC-së.

X. Pyetjet (më parë seksioni VII)

- Rishikon informacionin e kontaktit për pyetje.

PËRMBLEDHJE

Kjo rregullore përcakton politikën kundër diskriminimit dhe ngacmimit të Departamentit të Arsimit të Qytetit të Nju-Jorkut që rregullon të folurit dhe sjelljen e anëtarëve të zgjedhur dhe të emëruar të këshillave të arsimit të distriktit për të gjithë qytetin dhe komunitetin dhe përcakton një procedurë për paraqitjen dhe zgjidhjen e ankesave për shkelje të kësaj rregulloreje. Ajo zëvendëson rregulloren D-210 të kancelarit, kodin e sjelljes dhe procedurat e ankesave të Këshillave të Arsimit të Qytetit dhe Komunitetit: Politika kundër diskriminimit dhe ngacmimit, datë 22 dhjetor 2021.

I. HYRJE

Departamenti i Arsimit i Qytetit të Nju-Jorkut (DOE) e pranon se udhëheqja dhe angazhimi i prindërve janë themeli i shkollave të DOE-së. Është politika e DOE-së të zhvillojë dhe të mirëmbajë një ambient

pozitiv dhe mbështetës për udhëheqësit e zgjedhur dhe të emëruar të prindërve, i cili është pa diskriminim, ngacmim, paragjykim, racizëm dhe frikësim. DOE është i përkushtuar ndaj trajtimit të të gjithë prindërve dhe nxënësve me respekt dhe dinjitet dhe ofrimit të mundësive për pjesëmarrje të drejtë dhe angazhim të prindërve. DOE është i përkushtuar për të mirëpritur identitete të ndryshme racore, gjuhësore dhe kulturore në udhëheqjen e prindërve, si dhe për të fuqizuar prindërit si agjentë të ndryshimit shoqëror.

Në përputhje me ligjin "Për arsimin", anëtarët e këshillit janë përgjegjës, ndër të tjera, për të nxitur arritjen e standardeve dhe objektivave arsimore që lidhen me mësimdhënien e nxënësve, siç përcaktohet më plotësisht më poshtë në seksionin III, "Detyrat e CCEC-ve".

Si udhëheqës prindërisht të zgjedhur ose të emëruar, anëtarët e këshillit kanë detyrën të respektojnë një standard të lartë etike, integriteti dhe mirësjelljeje. Anëtarët e këshillit pritet të jenë modele shembullore në këshilla dhe në komunitetet ku shërbejnë, si dhe të përmbushin përgjegjësitë e tyre në një mënyrë që respekton të drejtat e prindërve dhe nxënësve të cilëve u shërbejnë.

II. PËRKUFIZIME

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme.

- A. Këshilli i qytetit i referohet katër këshillave arsimore të përcaktuara në seksionin 2590-b të ligjit "Për arsimin": Këshilli i Qytetit për Shkollat e Mesme (CCHS), Këshilli i Qytetit për Arsimin Special (CCSE), Këshilli i Qytetit për Nxënësit e Gjuhës Angleze (CELL) dhe Këshilli i Qytetit për Distriktin 75 (CCD75).
- B. Këshilli i Arsimit i Distriktit për Komunitetin (CEC) i referohet 32 këshillave që qeverisin secilin prej distrikteve shkollore të komunitetit, siç përcaktohet në seksionin 2590-c të ligjit "Për arsimin".
- C. CCEC i referohet këshillave të qytetit dhe CEC-ve, së bashku.
- D. Sjellja i referohet akteve dhe sjelljes fizike kur ndodhin gjatë ose në takimet ose aktivitetet e CCEC-së; ngjarjeve të organizuara nga CCEC; ngjarjet zgjedhore dhe/ose të fushatës së CCEC-së; dhe/ose paraqitjet publike dhe ngjarjet publike në të cilat një anëtar i këshillit merr pjesë në cilësinë e tij zyrtare.
 - 1. Megjithatë, sjellja e përshkruar në seksionin IV(B)(i), (iii) dhe (v) është e ndaluar në çdo ambient ku një sjellje e tillë ka gjasa të dëmtojë aftësinë e anëtarit të këshillit për të kryer në mënyrë efektive detyrat e tij.
- E. Anëtar i këshillit i referohet një anëtarit të zgjedhur ose të emëruar të një CCEC-u.
- F. Zbulimi i informacionit i referohet lejit të aksesit, ose publikimit, transferimit ose komunikimit tjetër të informacioneve personale të identifikueshme që ndodhen në regjistrat mësimorë me anë të çdo mjeti, duke përfshirë mjetet verbale, me shkrim ose elektronike, të çdo palë përveç palës së identifikuar si pala që ka ofruar ose krijuar të dhënat, në përputhje me ligjin "Për të

D-210 – POLITIKA DHE PROCEDURAT E ANKESAVE TË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË DISTRIKTIT PËR KOMUNITETIN DHE QYTETIN NË LIDHJE ME SJELLJEN, ANTIDISKRIMINIMIN DHE ANTINGACMIMIN

drejtat dhe privatësinë e familjes në arsim", 20 U.S.C. 1232g, dhe rregulloret zbatuese të tij, 34 C.F.R., pjesa 99 e në vijim (FERPA).

- G. Regjistri mësimor do të ketë të njëjtin kuptim siç përcaktohet në FERPA, një regjistër që lidhet drejtpërdrejt me nxënësin dhe mbahet nga një agjenci ose institucion arsimor ose nga një palë që vepron për agjencinë ose institucionin.
- H. Nëpunësi i pajtueshmërisë për barazi (ECO) është një punonjës i caktuar i DOE-së, me përgjegjësi për marrjen, përgjigjen, përpunimin dhe hetimin e ankesave ku pretendohet shkelje e kësaj rregulloreje.
- I. FACE është Zyra e Fuqizimit të Familjes dhe Komunitetit e DOE-së, një ekip përgjegjës për mbështetjen e strukturave të qeverisjes së prindërve në distriktin shkollor të qytetit të Nju-Jorkut.
- J. Këshilli i Barazisë i FACE (Këshilli i Barazisë) është një ekip udhëheqësish prindërisht nga këshillat dhe Këshilli Këshillimor i Kancelarit për Prindërit, i përzgjedhur sipas një procesi të vendosur nga FACE, i cili i jep rekomandime FACE-s mbi punësimin dhe mbajtjen e ECO-s dhe mund të japë rekomandime mbi zgjidhjen e ankesave të paraqitura në ECO.
- K. Prindi është një prind, kujdestar ose person në marrëdhënie prindërore me fëmijën. Këtu përfshihen: prindi biologjik ose adoptues, njerku/njerka, kujdestari i emëruar ligjërisht, prindi birësues dhe "personi në marrëdhënie prindërore" me një fëmijë që ndjek shkollën. "Person në marrëdhënie prindërore" i referohet një personi që ka marrë përsipër kujdesin për një fëmijë sepse prindërit ose kujdestarët e fëmijës nuk janë të disponueshëm, qoftë për shkak të, ndër të tjera, vdekjes, burgimit, sëmundjes mendore, jetesës jashtë shtetit ose braktisjes së fëmijës.
- L. Informacioni personal i identifikueshëm ka kuptimin e përcaktuar në FERPA, dhe, në përputhje me FERPA-në, përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, informacionin e mëposhtëm nga regjistri mësimor i nxënësit: emrin e nxënësit ose prindit të nxënësit ose të anëtarëve të tjerë të familjes; adresën e nxënësit ose të familjes së nxënësit; identifikues personalë siç janë numri i sigurimeve shoqërore i nxënësit, numri i nxënësit ose regjistri biometrik; identifikues indirektë siç janë mosha e nxënësit, datëlindja, vendlindja, mbiemri i vajzërisë së nënës; informacione të tjera që vetëm ose në kombinim, janë lidhen ose mund të lidhen me një nxënësit specifik që do t'i lejonin një personi të arsyeshëm në komunitetin shkollor, i cili nuk ka njohuri personale për rrethanat përkatëse, ta identifikonte nxënësin me siguri të arsyeshme; ose informacione të kërkuara nga dikush që anëtar i këshillit beson në mënyrë të arsyeshme se e di identitetin e nxënësit me të cilin lidhet regjistri mësimor (PII).
- M. OSI është Zyra e Hetimeve Speciale e DOE-së.
- N. SCI është Komisioneri Special i Hetimit për distriktin shkollor të qytetit të Nju-Jorkut, një agjenci e pavarur që heton sjellje të pretenduara të pahijshme në distriktin shkollor të qytetit të Nju-Jorkut.
- O. I foluri i referohet përdorimit të gjuhës verbale dhe të shkruar nga një anëtar i këshillit, kur kjo ndodh gjatë ose në: mbledhjet, aktivitetet e CCEC-së, ose nëpërmjet komunikimeve të CCEC-së, duke përfshirë mesazhet elektronike ose postimet në llogaritë e rrjeteve sociale të CCEC-së; ngjarjet e organizuara nga CCEC-ja; ngjarjet zgjedhore dhe/ose të fushatës së CCEC-së; dhe/ose paraqitjet publike dhe ngjarjet në të cilat një anëtar i këshillit merr pjesë në cilësinë e tij zyrtarë.

1. Megjithatë, i foluri i përshkruar në seksionin IV(B)(i), (iii) dhe (v) është i ndaluar në çdo ambient ku një e folur e tillë ka gjasa të dëmtojë aftësinë e anëtarit të këshillit për të kryer në mënyrë efektive detyrat e tij.

III. PËRGJEGJËSITË E CCEC-ve

- A. Në përputhje me seksionet 2590-c dhe 2590-e të ligjit "Për arsimin", CCEC-të nuk kanë kompetenca ose funksione ekzekutive ose administrative, por kanë, ndër të tjera, kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:
1. Promovimin e arritjes së standardeve dhe objektivave arsimore që lidhen me mësimdhënien e nxënësve.
 2. Pjesëmarrjen në programe trajnimi dhe arsimit të vazhdueshëm siç përshkruhet në seksionin 2590-e(7) të ligjit "Për arsimin".
 3. Miratimin e vijave të ndarjes sipas dorëzimit nga drejtori i shkollës.
 4. Mbajtjen e takimeve të paktën një herë në muaj me drejtorin e shkollës për të diskutuar gjendjen aktuale të shkollave në qark dhe progresin e bërë drejt zbatimit të planit të përgjithshëm arsimor të distriktit, siç kërkohet nga kancelari.
 5. Rishikimin e programeve arsimore të distriktit dhe vlerësimin e ndikimit të tyre në arritjet e nxënësve.
 6. Mbajtjen e takimeve publike të paktën një herë në muaj me drejtorin e shkollës, gjatë të cilave publiku mund të flasë, në mënyrë që prindërit dhe komuniteti të kenë mundësinë të shprehin shqetësimet e tyre dhe të kenë një forum publik.
 7. Dorëzimin e një vlerësimi vjetor të të gjithë personelit tjetër mbikëqyrës të mësimdhënies që kanë përgjegjësi për më shumë se një shkollë brenda distriktit.
 8. Mbajtjen e një seance dëgjimore publike mbi planet vjetore të kapacitetit të distriktit.
 9. Ofrimin e sugjerimeve, sipas nevojës, për kancelarin dhe këshillin e qytetit mbi çështje të rëndësishme për distriktin.
 10. Ndërlidhjen dhe ndihmën me ekipet e udhëheqjes së shkollës, si dhe shërbimin në ekipin e udhëheqjes së distriktit duke caktuar një përfaqësues.
 11. Konsultimin për përzgjedhjen e drejtorit të komunitetit.
 12. Mbajtjen e një seance dëgjimore publike të përbashkët lidhur me një ndryshim të propozuar të rëndësishëm në përdorimin e shkollave, siç përcaktohet në seksionin 2590-e(21) të ligjit "Për arsimin".
- B. Sipas seksionit 2590-b të ligjit "Për arsimin", këshillat e qytetit kanë kompetencat dhe detyrat e mëposhtme, ndër të tjera:
1. Këshillimin dhe komentimin mbi politikat e mëposhtme arsimore ose mësimore:
 - a. Për CCHS, ofrimin e shërbimeve për nxënësit e shkollave të mesme;
 - b. Për CCSE, ofrimin e shërbimeve për nxënësit me aftësi të kufizuara;

- c. Për CCELL, ofrimin e shërbimeve që përfshijnë programe dygjuhëshe ose anglisht si gjuhë e dytë; dhe
 - d. Për CCD75, ofrimin e shërbimeve të distriktit 75;
2. Lëshimin e raporteve vjetore mbi efektivitetin e DOE-së në ofrimin e shërbimeve dhe dhënien e rekomandimeve, sipas rastit, se si të përmirësohet efikasiteti dhe ofrimi i shërbimeve të tilla në lidhje me nxënësit që ata u shërbejnë; dhe
3. Mbajtjen e të paktën një takimi në muaj që është i hapur për publikun, gjatë të cilit publiku mund të diskutojë çështje që ndikojnë te nxënësit që çdo këshill i qytetit u shërben.
- C. Anëtarët e këshillit janë përgjegjës për familjarizimin me këtë rregullore dhe pjesëmarrjen në të gjitha mundësitë e trajnimit dhe arsimit të vazhdueshëm të organizuara nga FACE në përputhje me seksionin 2590-e(7) të ligjit "Për arsimin". Një trajnim i tillë duhet të përfshijë udhëzime mbi pajtueshmërinë me këtë rregullore dhe duhet të përfundojë jo më vonë se tri muaj nga data kur anëtarë i këshillit merr detyrën për herë të parë.
- 1. Anëtarët e këshillit gjithashtu duhet të përfundojnë programet e arsimit të vazhdueshëm në bazë vjetore në përputhje me nenin 2590-e(7) të ligjit "Për arsimin", i cili do të përfshijë udhëzime plotësuese mbi pajtueshmërinë me këtë rregullore.
 - 2. Mosrespektimi nga anëtarët e këshillit i kërkesave të mësipërme për trajnim dhe arsim të vazhdueshëm përbën shkak për shkarkim nga detyra në përputhje me nenin 2590-l të ligjit "Për arsimin".

IV. SJELLJA E NDALUAR

- A. Anëtarët e këshillit nuk duhet të përfshihen në asnjë sjellje ose të folur që e nënshtrojnë një person ose entitet ndaj diskriminimit ose ngacmimit të paligjshëm në bazë të racës, ngjyrës, fesë, besimit, etnisë, origjinës kombëtare, tjetërsimit, statusit të shtetësisë, moshës, statusit martesor, statusit të partneritetit, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, gjinisë, gjatësisë, peshës dhe statusit ushtarak të ndaluar nga ligji vendor, shtetëror ose federal.
- B. Anëtarët e këshillit nuk duhet të përfshihen në sjelljen ose të folurit e mëposhtëm: (i) ngacmimin e qëllimshëm dhe të përsëritur të një personi tjetër që e vendos një person të tillë në frikë të arsyeshme nga lëndimi fizik; (ii) sjelljen ose të folurin që një person i arsyeshëm do të priste të provokonte një reagim të dhunshëm (duke përfshirë, por pa u kufizuar në përdorimin e fyerjeve bazuar në racë, gjini, orientim seksual, fe, origjinë kombëtare dhe aftësi të kufizuar që një person i arsyeshëm do të priste të provokonte një reagim të tillë); (iii) sjelljen ose të folurin që ata janë të vetëdijshëm se do të konsiderohej në mënyrë të arsyeshme nga të tjerët si kërcënim për dhunë; (iv) sjelljen ose të folurin është i turpshëm; ose (v) sjelljen ose të folurin që është i ndalur me ligj.
- C. Anëtarët e këshillit nuk duhet të përfshihen në sjellje ose të folur përçarës që pengon, ose ka të ngjarë të pengojë, CCEC-në të kryejë punën (duke përfshirë, por pa u kufizuar në sjellje ose fjalë si të bërtiturat, fyerjet ose shpërthimet fizike, kur një sjellje ose fjalë të tilla ndikojnë në kryerjen e punës së CCEC-së).
- D. Anëtarët e këshillit nuk duhet të kenë akses ose të zbulojnë informacion personal të

D-210 – POLITIKA DHE PROCEDURAT E ANKESAVE TË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË DISTRIKTIT PËR KOMUNITETIN DHE QYTETIN NË LIDHJE ME SJELLJEN, ANTIDISKRIMINIMIN DHE ANTINGACMIMIN

identifikueshëm (PII) për asnjë arsye tjetër përveç një qëllimi zyrtar dhe të autorizuar të këshillit, në përputhje me rregulloren A-820 të kancelarit dhe FERPA-n.

- E. Anëtarët e këshillit nuk duhet të përdorin asnjë listë emailësh, listserv, faqe interneti, llogari në rrjetet sociale ose platformë tjetër komunikimi në të cilën kanë akses përmes pozicionit të tyre si anëtar i këshillit, për përfitim personal ose privat, ose për të mbështetur një kandidat individual ose listë kandidatësh.
- F. Anëtarët e këshillit nuk duhet të zbulojnë asnjë informacion personal, duke përfshirë çdo informacion kontakti të prindit ose nxënësit të marrë nga këshilli, për komunikime personale, lobim, fushata ose aktivitete politike. Një informacion i tillë mund të përdoret vetëm për qëllime zyrtare dhe të autorizuar të këshillit, në përputhje me rregulloren A-820 të kancelarit dhe FERPA-n.
- G. Anëtarët e këshillit nuk duhet ta përdorin pozicionin e tyre për të përfituar personalisht ose financiarisht për veten e tyre, për të afërmit e tyre të ngushtë, siç përcaktohet në rregulloren C-110 të kancelarit, ose për çdo person ose firmë me të cilin ata kanë marrëdhënie biznesi ose financiare.
- H. Anëtarët e këshillit nuk duhet të hakmerren ndaj asnjë individi që kundërshton praktikat diskriminuese, që ankohet për diskriminim ose ngacim në përputhje me këtë rregullore, ose që paraqet ose merr pjesë në hetimin e një shkeljeje të pretenduar të kësaj rregulloreje.

V. MASAT KORRIGJUESE DHE DISIPLINORE

- A. Masat korigjuese ose disiplinore mund të jenë të përshtatshme kur anëtari i këshillit shkel seksionin IV të kësaj rregulloreje.
- B. Çdo masë korigjuese ose disiplinore duhet të ndërmerret në përputhje me seksionin 2590-I të ligjit "Për arsimin" dhe mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në, lëshimin e një urdhri për të ndaluar sjelljen ose të folurit e papërshtatshëm ose për të ndërmarrë masat e nevojshme, ose pezullimin ose largimin e anëtarit të këshillit.
- C. Anëtarët e këshillit që janë shkarkuar nga detyra për shkelje të seksionit IV të kësaj rregulloreje mund të ndalohen nga shërbimi më pas në çdo këshill, siç përcaktohet në seksionet 2590-c dhe 2590-I të ligjit "Për arsimin".

VI. PROCESI I ANKESAVE

- A. Paraqitja e një ankese
 - 1. Individët mund të paraqesin ankesa duke pretenduar shkelje të seksionit IV të kësaj rregulloreje pranë ECO-s duke e njoftuar ECO-n me email, telefon ose postë duke përdorur informacionin e kontaktit të dhënë në fund të kësaj rregulloreje.
 - 2. Ankesat duhet të përmbajnë emrin e ankuesit dhe një numër telefoni ose adresë emaili ku mund të kontaktohet. Ankesat anonime nuk do të pranohen. Ankesat duhet të përfshijnë gjithashtu informacionin e mëposhtëm, në masën që është i disponueshëm: identitetin e anëtarëve të këshillit të cilët dyshohet se kanë shkelur këtë rregullore; (ii) një përshkrim të

ngjarjeve që lidhen me këtë shkelje të pretenduar, duke përfshirë datat dhe vendet, sipas rastit; dhe (iii) dispozitat e seksionit IV të kësaj rregulloreje që dyshohet se janë shkelur.

3. Ankesa ku pretendohet shkelje e seksionit IV të kësaj rregulloreje duhet të dorëzohet jo më vonë se 60 ditë kalendarike pas incidentit të dyshuar.
4. Gjatë procesit të ankesës, do të ofrohen sipas nevojës shërbime ndihmëse gjuhësore, në përputhje me rregulloren e kancelarit A-663.
5. Përveç kësaj, individët mund të paraqesin ankesa duke pretenduar shkelje të kësaj rregulloreje direkt te SCI-ja në <https://nycsci.org/online-complaint-form/> or 212-510-1400.
6. Ankesa e paraqitur në ECO ku pretendohet një shkelje që përfshin korrupsion, aktivitet kriminal ose konflikt interesi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, disa shkelje të pretenduara të seksionit IV.F, G ose H, duhet t'i referohet SCI-së ose Bordit të Konfliktëve të Interesit në përputhje me rregulloret D-130 ose C-110 të kancelarit, sipas rastit, dhe, kur pretendohet aktivitet kriminal, Departamentit të Policisë së Qytetit të Nju-Jorkut.

B. Përgjigjja fillestare

1. ECO duhet t'i konfirmojë me shkrim ankimuesit marrjen e ankesës brenda 5 ditësh pune nga marrja. ECO duhet t'i japë njoftim për ankesat Këshillit të Barazisë FACE.
2. Ankesat duhet të mbahen në dosje në FACE. Ankesa dhe hetimi duhet të mbahen konfidenciale, përveç rasteve të përcaktuara në seksionin VI.C.3.
3. Nëse ECO, në konsultim me Këshillin e Barazisë, beson se shkelja e pretenduar është e natyrës kriminale, përbën një rrezik të menjëhershëm për sigurinë ose mirëqenien e nxënësve ose të ndonjë punonjësi të DOE-së, ose është në kundërshtim me interesin më të mirë të distriktit shkollor të qytetit të Nju-Jorkut, ECO mund të kërkojë që kancelari të pezullojë ose të shkarkojë anëtarin e këshillit që është subjekt i ankesës deri në përfundim të hetimit të ankesës.

C. Procedurat për hetimin e ankesave

1. ECO do ta shqyrtojë ankesën për të vendosur nëse pretendohet shkelje e kësaj rregulloreje.
2. Nëse ECO vendos se ankesa pretendon shkelje të kësaj rregulloreje, ECO do të kryejë një hetim duke marrë në pyetje palët dhe dëshmitarët dhe duke shqyrtuar provat përkatëse. Subjekti i ankesës ka të drejtën të përgjigjet ndaj pretendimeve.
3. Është politikë e Departamentit të Arsimit (DOE) të respektojë privatësinë e të gjitha palëve dhe dëshmitarëve në lidhje me ankesat e ngritura sipas kësaj rregulloreje. Megjithatë, nevoja për konfidencialitet duhet të balancohet me detyrimin për të kryer dhe për të bashkëpunuar me hetimet e kërkuara, për të garantuar të drejtën për proces të rregullt për subjektin dhe/ose për të ndërmarrë masat e nevojshme për pajtimin ose zgjidhjen e ankesës. Për këtë arsye, informacioni në lidhje me ankesën mund të duhet të zbulohet në disa rrethana, sipas rastit.
4. Pas përfundimit të hetimit, ECO do të dorëzojë një raport me shkrim të gjetjeve dhe një rekomandim për të përcaktuar nëse ka pasur shkelje të kësaj rregulloreje dhe masat

D-210 – POLITIKA DHE PROCEDURAT E ANKESAVE TË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË DISTRIKTIT PËR KOMUNITETIN DHE QYTETIN NË LIDHJE ME SJELLJEN, ANTIDISKRIMINIMIN DHE ANTINGACMIMIN

korrigjuese ose disiplinore të rekomanduara për Këshillin e Barazisë. Këshilli i Barazisë do të shqyrtojë gjetjet dhe rekomandimet dhe, brenda 10 ditësh kalendarike, do t'i paraqesë rekomandimin e tij ECO-s.

5. Në rast mosmarrëveshjeje midis ECO-s dhe Këshillit të Barazisë, do të mbizotërojnë rekomandimi i ECO-s.

D. Vendimi

1. Brenda 90 ditësh kalendarike nga marrja e ankesës nga ECO, ECO do t'i japë rekomandimin e tij kancelarit ose personit të caktuar prej kancelarit nëse ka pasur shkelje të kësaj rregulloreje, si dhe çdo masë të përshtatshme korrigjuese ose disiplinore, përveç nëse rrethanat e justifikojnë zgjatjen e periudhës kohore.
2. Brenda 10 ditësh pune nga marrja e rekomandimit nga ECO, kancelari ose personi i caktuar prej tij do të lëshojë një vendim me shkrim nëse ka pasur shkelje të kësaj rregulloreje, si dhe çdo masë të përshtatshme korrigjuese ose disiplinore, përveç nëse rrethanat e justifikojnë zgjatjen e periudhës kohore. Ankuesi(ët) dhe subjekti(ët) do të informohen me shkrim për vendimin.

E. Mundësia për pajtim

1. Përpara zbatimit të çdo mase korrigjuese ose disiplinore, anëtarit të këshillit që është subjekt i një mase të tillë do t'i jepet mundësia për pajtim me kancelarin ose personin e caktuar prej tij.
2. Kancelari mund të pezullojë ose të shkarkojë një anëtar të këshillit pa mundësi për pajtim nëse shkelja:
 - a. është me natyrë penale,
 - b. përbën një rrezik të menjëhershëm për sigurinë ose mirëqenien e nxënësve ose të çdo punonjësi të DOE-së, ose
 - c. sipas gjykimit të kancelarit, është në kundërshtim me interesin më të mirë të distriktit shkollor të qytetit të Nju-Jorkut.

VII. APELIMI

Anëtari i këshillit i pezulluar ose i shkarkuar në përputhje me urdhrin e lëshuar sipas kësaj rregulloreje dhe seksionit 2590-I të ligjit "Për arsimin", brenda pesëmbëdhjetë ditësh pas lëshimit të një urdhri të tillë, mund të paraqesë një apelim në Panelin për Politikën Arsimore ("Paneli") në përputhje me rregullat e përcaktuara në pjesën 113 të rregulloreve të komisionerit të arsimit. Ankesat duhet të dorëzohen te sekretari i panelit me email në adresën panel@schools.nyc.gov, dhe duhet ta identifikojnë qartë mesazhin si një apelim të drejtuar në vëmendje të sekretarit. Për informacione shtesë në lidhje me procedurat e apeliimeve, duke përfshirë kërkesat që lidhen me përmbajtjen e apeliimeve, dorëzimin e dokumenteve, kërkesat për ndalime të përkohshme dhe dorëzimin e përgjigjeve, referojuni pjesës 113 të rregullores së komisionerit të arsimit.

VIII. RISHIKIMI VJETOR

Kjo rregullore do të rishikohet çdo vit nga ECO dhe Këshilli i Barazisë dhe do të përditësohet nëse është në përputhje me ligjin dhe sipas nevojës në përputhje me të.

IX. HEQJA

Kjo rregullore ose çdo pjesë e saj mund të hiqet nga kancelari ose personi i caktuar prej tij nëse vendoset se është në interesin më të mirë të distriktit shkollor të qytetit të Nju-Jorkut.

X. PYETJE DHE KËRKESA PËR INFORMACION

Për çdo pyetje në lidhje me këtë rregullore, mund të kontaktoni:

Office of Family and Community Empowerment
N.Y.C. Department of Education
52 Chambers Street - Room 405
New York, NY 10007
Telefon: 212-374-4118
Emaili: FACE@schools.nyc.gov

Equity Compliance Officer
N.Y.C. Department of Education
52 Chambers Street - Room 405
New York, NY 10007
Telefon: 212-374-5101
Emaili: D210intake@schools.nyc.gov